

Vetë-testimi në shtëpi

Si të përdorni vetë-testimin iHealth COVID-19

1

Hapi 1: Përgatitni materialet

Në paketë und të keni Setin e Testit 1 OSE Setin e Testit 2. Ju lutemi ndiqni hapat e duhur bazuar në setin specifik që ju vjen.


Seti i Testit 1 vjen me:



Karta e testimit të COVID-19



Tubeti i mbushur me solucionin e testimit




Tamponi


Kur te jeni gati të filloni testin, hapni qesen prej fletë alumini të kartës së testit COVID-19

Ju lutemi shkoni direkt në Hapin 2 Merrni mostrën/kampionin


Seti i Testit 2 vjen me:




Karta e testimit të COVID-19



Tubeti bosh dhe Solucioni i vulosur




Tamponi



Buza 1

Buza 2




Buza 1

Buza 2



Buza 1

Buza 2



Buza 1

Buza 2

Kapni dy fundet e tubetit bosh pasta solucionin e vulosur e shtrydhni në tubetin bosh

Bëni kujdes që niveli i lëngut të jetë MBI buzën 2*

Kur te jeni gati të filloni testin, hapni qesen prej alumini të kartës së testit COVID-19

Ju lutemi kaloni direkt në Hapin 2 Merrni mostrën/kampionin

*Është e pranueshme nëse lëngu është MBI Buzën 2. Megjithatë, ju lutemi mos vazhdoni me testin nëse niveli i lëngut është nën Buzën 2, sepse kjo mund të na japë rezultat fals ose të pasaktë.

Për më tepër informacion vizitoni mass.gov/COVID19selftest

2

Hapi 2: Merrni mostrën



Hiqni tamponin nga paketimi
MOS E PREKNI MAJËN E TAMPONIT ME DUAR

Ruajeni paketën me tamponin për ta përdorur më vonë



Deri 3/4 inç

Me kujdes fusni majën e tamponit (zakonisht 1/2 deri 3/4 inç) në hundë

Kur bëhet te fëmijët, tamponi duhet të futet më pak se 3/4 inç thellë dhe ndoshta do t'ju duhet edhe dikush tjetër që të mbajë kokën e fëmijës gjatë marrjes së mostrës

E rrotulloni tamponin në paretet e brendshme të hundës në formë rrethore të paktën 5 herë

Këtë e bëni me kujdes dhe ngadalë - të paktën 15 sekonda për të mbledhur mostrën dhe që të siguroheni të merrni në tampon sekrecione të hundës

Duke përdorur të NJËJTIN TAMPON, përsëriteni procesin edhe në vrimën tjetër të hundës



Lëvizni me ngadalë x5



Lëvizni me ngadalë x5


Rezultati mund të mos jetë i saktë në rast se nuk do të merrni mostër të mjaftueshme

3

Hapi 3: Përpunoni mostrën





Përplaseni lehtë mbi tavolinë tubetin dhe pastaj rrotulloni kapakun e madh portokalli për ta hapur




Lëvizni x15

Lëvizni majën e tamponit në fund të tubetit të paktën 15 herë



Shtrëngoni anët e tubetit për të nxjerrë sa më shumë mostër nga tamponi

Nëse nuk e shtrydhni tamponin, mund të mos mbetet shumë material mostre për ta kryer testin si duhet




Hiqni tamponin dhe mbyllni kapakun e madh portokalli të tubetit

Futeni tamponin përsëri në paketë për ta hedhur

4

Hapi 4: Shtoni mostrën



Tani mostrën e keni në tubet

Për të testuar mostrën, hapni kapakun e vogël të bardhë të Tubetit duke e rrotulluar

Shtoni 3 pika të mostrës në vendin e mostrës në kartën e testit COVID-19


Mbylleni përsëri kapakun e vogël të bardhë

Prisni 15 minuta për rezultatin

Filloni të matni kohën menjëherë pasi keni hedhur mostrën në vrimën e mostrës. Rezultati do të jetë gati për 15 minuta dhe do të skadojë pas 30 minutave.

Një rezultat fals negativ ose pozitiv mund të dalë nëse rezultati i testit lexohet para 15 minutave ose pas 30 minutave.

Interpretimi i rezultateve



Rezultati pozitiv

Vini re se vija T mund të jetë e zbehtë.

Rezultati POZITIV duhet të tregohet në të DYJA vijat, vijën C dhe vijën T. Rezultat pozitiv do të thotë se personi është pozitiv për COVID 19.

Hyni në mass.gov/COVIDselftest për të parë se çfarë duhet të bëni. Duhet të kontaktoni mjekun e t'i thoni për rezultatin pozitiv, veçanërisht nëse keni probleme shëndetësore që ju sëmurin seriozisht po të merrni COVID-19

Rezultat i pasaktë: Nëse NUK do të ketë VIJA, ose nëse do të ketë VETËM vijën T, testi nuk ka funksionuar si duhet. Ju duhet të riestoheni me një pako të re testimi. Nëse edhe rezultati i ri nuk del, testohuni në një qendër testimi ose kontaktoni mjekun tuaj.

Hidheni pakon e testit: Pas përfundimit të testit, hidhni përbërësit e mbetur të pakos në plehra.

15 Min

3 pika

Rezultati negativ



Rezultati NEGATIV do të shfaqet VETËM në vijën C. Rezultat negativ do të thotë që personi presupozohet të jetë negativ për COVID-19.

Rezultati negativ nuk do të thotë se e përjashton plotësisht COVID-19. Nëse keni simptoma të COVID-19, veçanërisht nëse jeni ekspozuar ndaj dikujt me COVID-19, testohuni në një vend testimi ose përsërisni testin pas 1-2 ditëve dhe konsultohuni me mjekun tuaj.

